



REPUBLICA E KOSOVES / KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME-MINISTARSTVO INOSTRANIH POSLOVA-MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS	
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot. / Org. Jednica / Org. Unit: 2-0	Nr. Prot. / Prot.No: 1151
Nr. Fsheve / Broj sveske / No. pages: 04	Data / Datum / Date: 14.07.2020
Prishtine / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo inostranih poslova i dijaspore -
Ministry of Foreign Affairs and the Diaspora
Njësia e Auditimit të Brendshëm /Jedinica za unutrašnju reviziju / The Internal Audit Unit

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	33/2020				
PËR/ZA/TO:	Besnik Osmani, auditor i përgjithshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit Bedri Hamza, kryetar i komisionit për mbikëqyrje të financave publike (KMFP)				
CC:	Anëtarët e KMFP-së				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Meliza Haradinaj - Stublla, Ministre e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës				
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Morina, U.D. Sekretar i përgjithshëm MJD				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit për vitin 2019 nga Zyra Kombëtare e Auditimit				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	xx	Lokacioni: Kucni: Extension:	xx	Data: Datum: Date:	19.6.2020
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE:					X

Të nderuar,
z. Osmani,
z. Hamza,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pranuar raportin final të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2019 për ish – Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) tashmë e fuzionuar me ministrinë e punëve të jashtme, sipas vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020.

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, neni 23, pika 5, në mbështetje të Rregullores së Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, po ju dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2019 nga Zyra Kombëtare e Auditimit për ish-MDIS.

Me respekt!

Nr.	Fusha e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra apo të planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Paga dhe Mëditje	<p>Sipas ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 29- rastet e përjashtimit nga procedura, pika 1.7- një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vet atij.</p> <p>Gjatë testimit të procedurave të rekrutimit të brendshëm, në një rast kemi vërejtur se U.D i Sekretarit të Përgjithshëm përmes një vendimi ka caktuar komisionin përzgjedhës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për promovimin e investimeve strategjike, ku si Kryesues të këtij Komisioni kishte caktuar vetveten.</p> <p>Vendimi i tillë ishte bërë për arsye të mungesës së Drejtorit të Departamentit për pozitën në fjalë.</p>	<p>Ministri duhet të sigurojë se në të gjitha proceset ku nevojiten formimet e Komisioneve, Kryesues të atyre Komisioneve të mos caktohet zyrtari cili përfshihet në procedurë administrative, dhe në të njëjtën kohë, merr pjesë në shqyrtimin e ankesave si organ epror për një vendim të marrë prej vet atij.</p>	<p>Do të merren veprimet e nevojshme për shmangien e këtij veprimi, duke mos u caktuar kryesues i komisioneve apo ekipeve nga vet themeluesi i tyre.</p>	ZKA, Divizioni për burime njerëzore	Qershor 2020
2	Mallra dhe Shërbime	<p>Sipas UA nr.2004/07 për Udhëtime Zyrtare, mjetet të cilat merren si avans për udhëtim zyrtar duhet të arsyetohen në një afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Çdo vonesë përtej këtij afati është ligjrisht e pa arsyeshme, e aq më tepër vonesat me vite të tëra.</p> <p>Avanse të pambyllura në fund të viti 2019 ishin 17,443€. Një nga këto avanse në vlerë 6,014€ kishte mbetur i hapur që nga vitit 2017, ndërsa gjashtë (6) avanset e pa mbyllura në vlerë prej 7,423€ i takonin vitit 2018 dhe pesë (5) avanse të pambyllura në vlerë prej 4,005€ i takonin vitit 2019, dhe si të tilla, është dashur të mbyllen para përfundimit të vitit.</p> <p>Nga testimet i 9 mostrave kemi vërejtur se në një mostër avansi për udhëtime zyrtare në Itali në vlerë prej 1,041€ i realizuar me datën</p>	<p>Ministri duhet të siguroj se të gjitha avanset e mësipërme do të arsyetohen brenda periudhës së përcaktuar me rregulloret financiare. Në të kundërtën, shumat e pa arsyetuara t'u ndalen nga paga personave që kanë pranuar avanse.</p> <p>Gjithashtu, menaxhmenti duhet të forcoj kontrollet që barazimet/arsyetimi i shpenzimeve të avanseve të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore pa</p>	<p>Pas shumë kërkesave për arsyetimin/mbylljen e avansit për zyrtarët përkatës dhe duke parë mosveprimin nga ana e tyre për mbyllje, është nxjerrë Vendimi nr. 164 datë 11.02.2020 si veprim i ndërmarrë për ndalesën e 1/3 të pagës për mbajtësin e avanseve duke përfshirë edhe shumën 1,041.00 €, e cila është konsideruar si e gjetur.</p> <p>Për avanset e mbetura për vitet 2017 dhe 2018 nuk ka qenë e mundur të merret një vendim i tillë për shkak se mbajtësi i avanseve është në pushim pa pagesë për të cilin do të merren veprimet e nevojshme.</p>	ZKA, ZKF, departamenti ligjor.	Dhjetor 2020

		<p>28 tetor 2019, në bazë të dokumentacionit të vlerësuar me rastin e arsyetimit të shpenzimeve, për pjesën e avansit në vlerë prej 370€, përfituesi nuk kishte ofruar dëshmi për shpenzimet e ndodhura. Kjo vlerë është dashtë të kthehet në llogari të MDIS, por deri në përfundim të auditimit, kthimi i këtyre mjeteve nuk ishte bërë.</p> <p>Shuma e raportuar në PVF e avanseve pa arsyetuara dhe mos mbyllja e tyre ndër vite kishte ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e zyrtarëve përkatës për kthimin e mjeteve të pa arsyetuara si dhe mungesës së kontrolleve nga ana e zyrtarëve përgjegjës për aprovimin e këtyre shpenzimeve.</p>	asnjë vonesë.	Po ashtu, për zyrtarët të cilët kanë avanse të paarsyetuara/ mbyllura nuk do të autorizohen tërheqja e avanseve tjera pa u arsyetuar ato.		
3	Mallra dhe Shërbime	<p>Sipas Dosjes së Tenderit, Seksioni II- Fleta e të Dhënave të Tenderit, pika 14.1, para nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik, duhet të bëhet sigurimi i ekzekutimit me një afat të caktuar kohor.</p> <p>Gjatë auditimit, kemi vërejtur se në kontratën 'Shërbimet e transportit me autobus dhe minibus' LOT 1 me vlerë 18,700€ dhe LOT 2 me 13,500€, OE është shpërblyer me kontratë pa u bërë sigurimi i ekzekutimit nga ky i fundit. Ky sigurim është pranuar nga Ministria, pas përfundimit të auditimit.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se Departamenti i prokurimit nuk kishte qenë i vëmendshëm në zbatimin e kësaj kërkesë ligjore dhe kishte nënshkruar kontrata pa sigurinë e ekzekutimit.</p>	Ministri duhet të aplikoj masa përgjegjësie për mos zbatimin e kërkesave ligjore dhe të siguroj se para nënshkrimit të kontratave me OE-të, zyra e prokurimit ka kompletuar dosjen e prokurimit me gjithë dokumentacionin e kërkuar, përfshirë edhe sigurimin e ekzekutimit sipas kushteve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.	Do të rritet niveli i kontrollit në këtë sistem dhe para nënshkrimit të çdo kontrate do të kërkohej të dorëzohet sigurimi i ekzekutimit, aty ku kërkohej.	Menaxheri i prokurimit	Qershor 2020.

4	Subvencione dhe Transfere	<p>Sipas Rregullores për Subvencione Nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 14, përfituesit e subvencioneve pas përfundimit të projektit duhet të dorëzojnë raporte, si dëshmi për mënyrën e shfrytëzimit dhe arsyetimit të fondeve.</p> <p>Gjatë testimeve të shtatë (7) mostrave kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste përfituesit nuk kishin raportuar konform kushteve të kontratës. Më tej, MDIS nuk kishte caktuar zyrtarët përgjegjës për monitorimin dhe implementimin e projekteve.</p> <p>Nga shtatë (7) raste, pesë (5) projektet e financuara sipas kontratës ishin paraparë të përfundonin në periudhën qershor-shtator, ndërsa në dy raste projektet do të përfundonin në muajin nëntor 2019.</p> <p>Shkaku i mos raportimit nga përfituesit e subvencioneve, ishte mos emërimi i zyrtarëve për monitorim dhe angazhimi i pa mjaftueshëm i sektorit përgjegjës për adresimin e kësaj kërkesë të OJQ-të</p>	<p>- Ministri duhet të emëroj zyrtarët përgjegjës për monitorimin dhe implementimin e projekteve, dhe me rastin e lidhjes së marrëveshjeve me përfituesit e subvencioneve, të përcaktohen qartë kushtet dhe afatet e raportimit. Në të kundërtën, të mos alokoj pjesën e mbetur të subvencioneve derisa të dorëzohen raportet për shpenzimet e lejuara më herët.</p> <p>- Ministri duhet të siguroj se komisioni për vlerësim ka parasysh të gjitha kriteret e përcaktuara në thirrje publike dhe në asnjë rast nuk do të subvencionoj OJQ-të apo personat fizik pa i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara sipas thirrjes publike.</p>	<p>Megjithëse ish-MDIS në bazë të vendimit nr. 970, datë 13.06.2019 si dhe vendimit nr. 1159 i datës 05.07.2019, ka themeluar komisionet për monitorimin e subvencioneve të cilët kanë bërë monitorimin e të gjitha projekteve të subvencionuara nga MDIS, në të ardhmen, për secilin projekt do të caktohet një person përgjegjës apo ekip për monitorimin e mbështetjes si dhe do të rritet niveli i kontrollit në këtë sistem.</p>	<p>ZKA, Komisioni i monitorimit</p>	<p>Qershor – Dhjetor 2020</p>
---	----------------------------------	--	---	---	---	-----------------------------------